



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

INSTITUCIONI I PREFEKTIT TË QARKUT DURRËS





Historiku



- ▶ **Qeverisja e Durrësit në vitet 1912-1944**
- ▶ Pas shpalljes së Pavarësisë më 28 Nëntor 1912, Qeveria e Vlorës bëri ndarjen administrative të vendit në Prefektura dhe Komuna. Durrësi ishte Prefekturë. Prefekti ishte përfaqësues i Shtetit, ndër ta përmendim: Hamid Toptani, Abdyl Ypi, Shefki Shatku, Ali Koka, Rexhep Jella, Zef Kadare.
- ▶ Nga viti 1912 deri më vitin 1926, Prefektura e Durrësit ishte Prefektura kryesore në vend dhe Tirana ishte Nënprefekturë nën juridiksionin e saj.
- ▶ **Qeverisja e Durrësit pas vitit 1944**
- ▶ Pas çlirimit të vendit u ruajt organizimi në Prefektura, N/Prefektura dhe Lokalitete, duke hequr Bashkitë dhe Komunat. Durrësi ishte Prefekturë.
- ▶ Në vitin 1953 u kalua në një ndarje të re Administrative.
- ▶ Njësta më e madhe u emërtua Qarku, i ndarë në Rrethe dhe Lokalitete.





Historiku

- ▶ **Qeverisja e Durrësit pas viteve 1990**
- ▶ Me ndryshimin e sistemit në vitin 1992, u bë një ndarje e re administrative në Prefekturë, Rreth, Bashki dhe Komunë.
- ▶ Forma e organizimit me Prefektura u rivendos përsëri në vitin 1992, me miratimin e ligjit "Për prefekturat", më datë 22 shtator 1992. Më 26 korrik 1993, Këshilli i Ministrave nxori vendimin për ndarjen dhe krijimin e 12 prefekturave në vend.
- ▶ Me Kushtetutën e vitit 1998 vendi u nda në Qark, Bashki dhe Komunë. Durrësi ishte Bashkia më e madhe e Prefekturës së Qarkut të Durrësit. Prefektura e Qarkut të Durrësit kishte nën juridiksionin e saj 16 Bashki dhe Komuna.
- ▶ Në vitin 2015, me miratimin e ndarjes së re administrative Prefektura e Qarkut Durrës ka aktualisht nën juridiksionin e saj 3 Bashki të mëdha, Durrës, Krujë dhe Shijak.






Prefektët e Qarkut të Durrësit ndër vite



▶ **Martin Cukalla**
(01.09.1997 – 15.02.2000)



Petrit Ajazi
(16.01.2000 – 06.02.2001)



Agron Duka
(06.02.2001 – 31.05.2001)



Natasha Paço
(01.11.2001 – 15.10.2002)



▶ **Gëzim Agasi**
(15.10.2002 – 30.01.2004)



Ingrid Shuli
(30.01.2004 – 30.09.2005)



Klodjan Pajuni
(01.10.2005 – 30.10.2009)



Genc Alizoti
(01.11.2009 – 5.04.2013)



Genc Juka
(05.04.2013 – 01.10.2013)



Prefektët e Qarkut të Durrësit ndër vite



Rolant Xhelilaj
(01.10.2013 – 05.05.2017)



Emiljan Jani
(05.05.2017 – 01.11.2017)



Roland Nasto
(01.11.2017 – 07.04.2022)



Emilian Jani
(07.04.2022 – në vazhdim)



STRUKTURA ADMINISTRATIVE E QARKUT DURRËS

QARKU DURRËS

3 BASHKI

16 NJËSI ADMINISTRATIVE

6 QYTETE

116 FSHATRA



BASHKIA DURRËS

6 NJËSI ADMINISTRATIVE

3 QYTETE

39 FSHATRA



BASHKIA KRUIJË

6 NJËSI ADMINISTRATIVE

2 QYTETE

50 FSHATRA



BASHKIA SHIJAK

4 NJËSI ADMINISTRATIVE

1 QYTET

27 FSHATRA



Bashkia Durrës

- ▶ **Bashkia e Durrësit** shtrihet përgjatë bregut të detit dhe kufizohet në perëndim me Detin Adriatik, në veri me bashkinë Kurbin, në lindje me bashkitë Krujë, Vorë e Shijak dhe në jug me bashkinë Kavajë.
- ▶ Durrësi ka portin më të madh në Shqipëri, ku përpunohet mbi 90 % e të gjithë volumit të ngarkim-shkarkimit portual, gjë që e bën atë njën më të rëndësishme tregtare në vend.
- ▶ Bashkia Durrës, përbëhet nga gjashtë njësi administrative, të cilat janë: Durrësi, Sukthi, Ishmi, Katundi i Ri, Rrashbulli dhe Manëz, me sipërfaqe 338.3 Km². Në territorin e bashkisë së re gjenden tre qytete, Durrës, Sukth dhe Manëz si dhe 39 fshatra.
- ▶ Durrësi është gjithashtu një zonë e rëndësishme arkeologjike, pasi nën qytetin aktual gjenden disa shtresa qytetërimesh antike.
- ▶ Relievi është kryesisht fushor dhe kodrinor: Lartësia më e madhe e qytetit është Kodra e Durrësit me 178 m e lartë.
- ▶ Vija kufitare dhe bregdetare: 114 km e gjatë dhe ndahet në:
 - Kufij tokësor: 45.3 km
 - Kufij lumor : 7.1 km
 - Vijë bregdetare: 61.6 km
 - Sipërfaqja e Bashkisë Durrës: 341.9 km²
 - Sipërfaqja e qytetit: 46.1 km²



Qarku	Qendra e Bashkisë	Njësitë Administrative përbërëse	Qytetet dhe fshatrat në përbërjen e tyre
Durrës	Qyteti Durrës	Qyteti Durrës (6 rajone)	Qyteti Durrës (6 rajone)
		Sukth	Qyteti Sukth, Fshatrat; Hamallaj, Kullë, Perlat, Vadardhë, Rushkull, Hidrovori
		Ishëm	Fshatrat; Likmetaj, Kërtushaj, Kapidanaj, Gjuricaj, Lalëz, Kuraten, Bizë, Draç, Shetaj,
		Katundi i ri	Fshatrat; Katundi i ri, Jubë, Qerret, Fllakë, Bisht-Kamëz, Rinia, Erzen, Sukth, Adriatik
		Rrashbull	Fshatrat; Rrashbull, Arapaj, Shënavlash, Shkallnur, Manskuri, Romanat, Bozaxhije, Xhafzotaj,
		Manëz	Qyteti Manëz, Fshatrat; Armath, Borç, Hamallaj, Kameras, Radë, Shkallë, Fshat Manëz



Durrësi dikur





Durrësi sot





Bashkia Krujë



- ▶ Bashkia ka 2 qytete (Kruja dhe Fushë-Kruja) dhe 50 fshatra të shtrira në 6 njësi administrative Krujë, Fushë-Krujë, Bubq, Nikël, Thumanë dhe Cudhi me sipërfaqe 339.02 km².
- ▶ Bashkia Krujë kufizohet: në lindje me Bashkitë Mat, Klos dhe Tiranë; në veri me Bashkitë Mat dhe Kurbin; në jug me Bashkitë Tiranë, Kamëz dhe Vorë; në perëndim me Bashkinë Durrës.
- ▶ Relievi i qytetit Krujë paraqet një mozaik formash dhe tipologjisht me lartësira që zbresin gradualisht në drejtimin lindje-perëndim. Zona fushore shtrihet në perëndim midis kodrave të Ishmit – Prezë, Tapizë, Krastë Krujë. Zona kodrinore ka një lartësi 100-300 m lartësi mbi nivelin e detit. Zona malore përbëhet nga dy vargje paralele me drejtim veri-perëndim dhe jug-lindje. Vargu Kruje-Dajt dhe vargu Skenderbej.
- ▶ Kruja njihet si kryeqendra e rezistencës ndaj pushtuesve osmanë gjatë kohës që Skënderbeu udhëhiqte këtë rezistencë. Dallohet dhe për pazarin të vjetër karakteristik, me vlera të rralla në Ballkan si dhe për zhvillimin e zejeve të ndryshme si punimi i leshit, metalit dhe drurit.
- ▶ Sipas statistikave të vitit 2017 këtë qytet e kanë vizituar rreth 305 mijë turistë vendas e të huaj.



Qarku	Qëndra e Bashkisë	Njësitë Administrative përbërëse	Qytetet dhe fshatrat në përbërjen e tyre
Durrës	Qyteti Krujë	Krujë	Qyteti Krujë, Fshatrat: Barakanesh, Picërragë, Brret
		Fushë- krujë	Qyteti Fushë Krujë, Fshatrat: Fushë Krujë, Arrameras 1, Luz 1, Hasan, Larushk 1, Halil, Zgërdhesh, Zallë, Luze 2, Larushke 2, Arrameras 2
		Bubq	Fshatrat: Bubq, Bilaj, Budull, Mazhë – Madhe, Mazhë – Vogël, Mallkuç, Murqinë
		Nikël	Fshatrat: Nikël, Tapizë, Qerekë, Rinas, Virjon, Buran, Mukaj, Kurcaj, Zezë
		Thumanë	Fshatrat: Kodër-Thumanë, Borizanë, Derven, Gramëz, Thumanë, Bushnesh, Dukagjin i Ri, Sukth-Vendas, Miliska, Derven Kodër,
		Cudhi	Fshatrat: Cudhi-Zall, Nojë, Mafsheq, Shqezë, Shkretë, Cudhi – Kant, Kroj Madh, Bruz-Zall, Bruz-Mal, Rranxë





Kruja simbol i rezistencës së shqiptarëve me në krye Heroin tonë Kombëtar Gjergj Kastriot Skënderbeun.

- ▶ Emri dhe rëndësia e Krujës lidhet me veprën dhe aktivitetin 25-vjeçar të Heroit tonë Kombëtar, Gjergj Kastriotit, i cili e shëndërroi Krujën dhe kështjellën e saj në një pikë rezistence ndaj osmanëve duke e bërë atë të njohur në të gjithë Europën. Periudha më e lavdishme fillon më më 28 nëntor 1443 kur Kalaja e Krujës u mor nën kontrollin e Gjergj Kastriotit i cili organizoi rezistencën e gjatë anti otomane.
- ▶ Tri herë e rrethuan osmanët Krujën (1450,1466,1467) me ushtri të mëdha (në Krujë kanë ardhur dhe dy nga sulltanët më të fuqishëm të perandorisë osmane sulltan Murati II dhe i biri i tij Mehmeti II), megjithatë kalaja e Krujës rezistoi.
- ▶ Ra nën sundimin osman vetëm në vitin 1478 (10 vjet pas vdekjes së Skënderbeut).





Kruja dikur





Kruja sot





Bashkia Shijak



- ▶ Bashkia përbëhet nga qyteti i Shijakut dhe 27 fshatra, të cilët janë pjesë përbërëse e 4 Njësive Administrative: Shijak, Maminas, Xhafzotaj dhe Gjepalaj, me sipërfaqe 92.19 km².




- ▶ Territori i Bashkisë gjendet në pjesën qendrore-perëndimore të Republikës së Shqipërisë dhe kufizohet: në lindje me Bashkitë Tiranë dhe Vorë; në veri me Bashkitë Vorë dhe Durrës; në jug me Bashkitë Durrës dhe Tiranë dhe në perëndim me Bashkinë Durrës.

- ▶ Bashkia Shijak duke u nisur dhe nga tiparet e relievit ka nje potencial te madh per zhvillimin e agroturizmit. Agroturizmi po merr një vëmëndje të veçantë, duke i shëndruar kështu këto zona në një destinacion tërheqës për turistët dhe pushuesit vendas dhe të huaj.

Qarku	Qëndra e Bashkisë	Njësitë Administrative përbërëse	Qytetet dhe fshatrat në përbërjen e tyre
Durrës	Qyteti Shijak	Shijak	Qyteti Shijak
		Maminas	Qyteti Sukth, Fshatrat; Hamallaj, Kullë, Perlat, Vadardhë, Rushkull, Hidrovori
		Xhafzotaj	Fshatrat; Likmetaj, Kërtushaj, Kapidanaj, Gjericaj, Lalëz, Kuraten, Bizë, Draç, Shetaj,
		Gjepalaj	Fshatrat; Katundi i ri, Jubë, Qerret, Fllakë, Bisht-Kamëz, Rinia, Erzen, Sukth, Adriatik





Shijaku dikur



Fotografi e gjetur ne Arkivin e shtetit.

Fotografia e ripunuar sipas kujtimeve te te moshuarve.



Agim Faja "SHIJAKU I VITIT 1920" / 1980 - vaj - 68 x 42 cm.



Shtëpia ku ka banuar NDINI RISTANI, ne qender te qytetit.

/ foto te vitit 1987.1

dyqani i ZYLYF SHTRAZES...



...dhe kafja e xha LUFTES, (LUFTULLA SHAHINIT).





Shijaku sot





Të dhëna mbi qarkun Durrës



- ▶ **Qarku Durrës** përbëhet nga tre Bashki: **Durrës, Shijak** dhe **Krujë**.
- ▶ Njësitë Administrative në Qark janë **16** (gjashtëmbëdhjetë).
- ▶ Në mbështetje të veprimtarisë së Prefektit të Qarkut Durrës dhe në përbërje të administratës së tij përfshihet **Nënprefektura Krujë**.



Sipërfaqja: 766 km²

Popullsia: 468 467 banorë



Shtrirja gjeografike dhe Kufizimet

- ▶ Qarku Durrës është i vendosur në bregdetin qendror shqiptar, me gjatësi rreth 33 km. Territori i saj në veri kufizohet me Qarkun Lezhë, në veri lindje me Qarkun Dibër, në jug me Qarkun Tiranë dhe në perëndim kemi dalje në detin Adriatik.
- ▶ Pozicioni gjeografik i Qarkut Durrës, ndodhet ndërmjet 41° e $36'$ deri 41° e $15'$ gjërësi gjeografike Veriore dhe 19° e $15'$ deri 19° e $38'$ gjatësi gjeografike Lindore e vendosur në një nga pikat më të ngushta të Detit Adriatik.
- ▶ Gjatësia e përgjithshme e vijës kufitare është 121.3km. Nga këta 52.4 km janë kufij tokësorë, 61.8 km kufij detarë, 7.1 km janë kufij lumorë.



Harta e Qarkut Durrës



Malet dhe lumenjtë

- ▶ Zona malore përbëhet nga dy vargje paralele me drejtim veri-perendim dhe jug-lindje. Vargu Kruje-Dajt dhe vargu Skenderbej (maja e Liqenit që është dhe maja më e lartë e rrethit Kruje).
- ▶ Lumenjtë kryesorë që përshkojnë Qarkun Durrës janë lumenjtë Erzen dhe Ishëm.
 - Lumi Erzen buron nga Mali me Gropa, në një lartësi -1200 m mbi nivelin e detit, 25 km në lindje të Tiranës, pranë Shëngjergjit dhe derdhet në Gjirin e Lalëzit në veri të Durrësit.
 - Lumi Ishëm rrjedh përmes Shqipërisë qendrore 74 km i gjatë, sipërfaqja e pellgut ujëmbledhës është 673 km² dhe lartësia mesatare mbi nivelin e detit 357 m. Ai formohet nga bashkimi I lumit të Tiranës, përrenjëve Tërkuza dhe Zeza.






Rëndësia e Qarkut Durrës në zhvillimin ekonomik të Shqipërisë.

- ▶ Pozicioni shumë i favorshëm gjeografik e bën qarkun e Durrësit një nyjë lidhëse kryesore për të gjitha llojet e transportit.
- ▶ **Tirana International Airport "Nënë Tereza"** në Rinas (**Bashkia Krujë**) është ndërtuar gjatë periudhës kohore 1955 -1957. Është aeroporti i kryeqytetit dhe njëkohësisht i vetmi aeroport ndërkombëtar i Shqipërisë për fluturime civile. Nga Rinasi fluturojnë disa avionë të shoqërive të fluturimit drejt destinacioneve të Evropës, dhe prej pikave të tranzitit për në disa qytete të tjera jo evropiane.
- ▶ **"Hekurudha Shqiptare"** është sistemi hekurudhor shqiptar. Terminali kryesor i vendit është në **Durrës**. Rrjeti hekurudhor shtrihet nga Porti i Durrësit dhe shkon në tre drejtime: në veri drejt kufirit shqiptaro-malazez në Han të Hotit, në jug drejt Ballshit dhe Portit të Vlorës dhe në lindje drejt Pogradecit. Të dhënat aktuale nga Ministria e Transporteve tregojnë se Hekurudha Shqiptare ka në inventarin e saj 66 vagonë udhëtarësh, 225 vagonë malli dhe 25 lokomotiva dhe më shumë përdoret për transportin e mallrave nga porti drejt destinacioneve vendase dhe të huaja.
- ▶ **Porti i Durrësit** është porti më i madh në Shqipëri dhe ndër më të mëdhenjtë në detin Adriatik dhe Jon, dhe një nyje shumë të rëndësishme për tregun ndërkombëtar.

 **Tirana International Airport**
Nënë Tereza





Porti i Durrësit

- ▶ Pozicioni i favorshëm gjeografik e bën portin e Durrësit portin më të madh në Shqipëri dhe ndër më të mëdhenjtë në detin Adriatik dhe Jon, dhe një nyje shumë të rëndësishme për tregun ndërkombëtar.
- ▶ Infrastruktura operationale e tij përbëhet nga 11 kalata me një thellësi kalate që varion nga 7.5m-11.5m.
- ▶ Mallrat kryesore që përpunohen në port janë mallrat e përgjithshme drithra, kontainer, tragete ,minerale etj.
- ▶ Porti i Durrësit ka aktualisht 78% te tregëtisë detare në nivel kombëtar.
- ▶ Porti i Durrësit është gjithashtu një vendndodhje kyce për rrjetet e trageteve dhe tranzitin e pasagjerëve, duke i dhënë Durrësit nje pozicion strategjik në lidhje me Korridorin VIII, që do facilitojë tranzitin e pasagjerëve dhe mallrave në kontinentin Europian.
- ▶ Porti i Durrësit shërben si vendkalim kufitar që në kohë të hershme. Ka lidhje trageti të përditshme me portin e Barit dhe lidhje disa ditë në javë me portet e Ankonës dhe Triestes në Itali.

Autoriteti Portual Durrës

D U R R Ë S P O R T A U T H O R I T Y





Turizmi


Veçantia e Qarkut të Durrësit është gërshetimi në mënyrë harmonike i turizmit detar, atij agroturistik dhe turizmit malor të ndërthurur dhe me arkeologjinë dhe historinë mijëra vjeçare të qytetërimit dhe zhvillimit të këtij territori.






Monumentet Kulturore

- ▶ Janë rreth 100 objekte të klasifikuara burime turistike monumente kulture Historiko/Arkeologjike si psh:
- ▶ Kalaja e Durrësit,
- ▶ Kalaja e Ishmit,
- ▶ Kalaja e Skënderbeut,
- ▶ Kalaja e Krujës,
- ▶ Kalaja e Zgërdheshit (Albanopoli),
- ▶ Anfiteatri i Durrësit,
- ▶ Rotonda,
- ▶ Termet e qytetit,
- ▶ Bazilika e Arapajt,
- ▶ Bazilika e Gjuricës,
- ▶ Kisha e Shën Ndout,
- ▶ Pazari i Krujës etj.
- ▶ Krahas këtyre si pika të vizitueshme janë Muzeumet Historik, Arkeologjik dhe Etnografik të Durrësit e të Krujës, Torra Veneziane si dhe Vila e Mbretit etj.



Monumentet më të rëndësishëm të natyrës

- ▶ Kepi dhe Falezë e Rodonit,
- ▶ Plazhi i Kallmit,
- ▶ Çinari i Balliasit,
- ▶ Plazhi i Shënpjetrit,
- ▶ Shkëmbi i Kavajës,
- ▶ Rrapi i Rubjekës,
- ▶ Pylli i Kolndrekajve,
- ▶ Rrepet e Arramerasit,
- ▶ Gryka e Zezë (Krujë),
- ▶ Gryka e Vajës ose Shkëmbi i Vajës,
- ▶ Kroi i Nënës Mbretereshë (Krujë),
- ▶ Sarisalltiku dhe shpella,
- ▶ Selvia e Teqesë (Fushë Krujë),
- ▶ Rrapi i Taslloit (Krujë),
- ▶ Rrapi i Ballabanecit (Krujë),
- ▶ Rrapi i Buranit,
- ▶ Pisha e Zezë në Qafë Shtamë,
- ▶ Rrapi ose Çinari i Bretit etj.





Rrjeti Rrugor/Sheshet

Gjatësia e rrugëve nacionale në territorin e Qarkut Durrës:

- ▶ 1. Rrugë interurbane kryesore **26.70 km**
- ▶ 2. Rrugë interurbane dytesore **65.85 km**
- ▶ 3. Rrugë dytësore **119.20 km**

Në lidhje me gjatësinë e rrjetit Rrugor Nacional dhe Rrugëve rajonale të dhënat për Bashkinë Shijak afersisht janë:

- ▶ Sheshi qendror i Bashkise Shijak: **5600 m²**
- ▶ Rruge rajonale: **57.022 m (57km)**
- ▶ Rruge nacionale: **23.200 m (23.2km)**

Ku rruge nacionale jane marre:

Rruga e vjeter 4 rruget - maminas sukth –
- maminas - vlashaj si dhe fllake - autostrade.





Arsimi

Arsimi në qarkun tonë ndiqet dhe monitorohet nga **Drejtoria Arsimore Rajonale Durrës** e cila mbulon kryesisht Bashkinë Durrës dhe Shijak dhe nga Zyra Arsimore Krujë që mbulon territorin e Bashkisë Krujë.

Bashkia Durrës

- ▶ 5 çerdhe me ushqim
- ▶ 10 kopshte publike nga të cilët 7 me ushqim dhe 3 pa ushqim
- ▶ 72 shkolla 9-vjeçare nga të cilat 55 publike dhe 17 private
- ▶ 32 shkolla të mesme nga të cilat 13 publike (ku në dy shkolla zhvillohet dhe part time – Olsi Lasku dhe Sukthi i Ri part time); 1 e mesme profesionale; dhe 18 private (ku njëra është part time)

Bashkia Shijak

- ▶ 1 çerdhe publike
- ▶ 2 kopshte publike
- ▶ 16 shkolla 9-vjeçare publike
- ▶ 2 shkolla të mesme të përgjithshme

Bashkia Krujë:


- ▶ 2 çerdhe me ushqim (publik)
- ▶ 3 kopshte me ushqim (publik)
- ▶ 26 kopshte në godinën e shkollës (publik)
- ▶ 1 kopësht në godinën e shkollës (privat) me ushqim
- ▶ 2 gjimnaze publike
- ▶ 4 shkolla të mesme të bashkuara
- ▶ 37 shkolla 9-vjeçare (nga ku 8 janë shkolla vetëm fillore pra cikli i ulët) (publike)
- ▶ 1 shkollë 9-vjeçare (private) me ushqim





Universiteti Durrës

- ▶ Universiteti mesjetar i Durrësit u hap në vitet `80 të shekullit XIV. Ai konsiderohet universiteti i parë mesjetar në Ballkan dhe njëri ndër universitetet e para të Evropës.
- ▶ Universiteti mesjetar i Durrësit ishte universitet teologjik (Studium Generale). Atë e themeluan dhe e drejtuan autoritetet e urdhërit dominikan të qytetit të Durrësit. Kur u themelua kishte 9 magjistër dhe 100 studentë. "Durrësi ka qenë qendër studimesh jo vetëm për Shqipëri, por edhe për Bosnjë, Dalmaci, dhe Hungari.
- ▶ Në Universitetin mesjetar të Durrësit u promovuan shumë doktorë shkencash dhe u përgatitën shumë teologë që punuan meshtarë, jo vetëm në viset shqiptare, por edhe në Dalmaci dhe në Itali. Njëri ndër personalitetet më të njohura i cili doli nga dyert e këtij universiteti ka qenë Gjon Durrsaku, i cili më 14 qershor të vitit 1396 caktohet rektor i Universitetit të Zarës (Universitas Jadertina). Veprimtaria e këtij universiteti u ndërpre në vitin 1501, kur ushtritë osmane pushtuan Durrësin.
- ▶ Universiteti Aleksandër Moisiu Durrës (UAMD) është krijuar me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr. 801, datë 20 dhjetor 2005 "Për hapjen e Universitetit "Aleksandër Moisiu" Durrës". Universiteti i Durrësit mban emrin e aktorit të famshëm shqiptarë të skenës gjermano-folës Aleksandër Moisiu.
- ▶ Kampusi i ri i Universitetit po ndërtohet në një sipërfaqe prej 48.300 m², ndërkohë që sipërfaqja e ndërtimit do të jetë 11.470 m². Korpusi i ri do të ketë godina për fakultetet dhe ndërtesa të veçanta për konviktet, komplekse shërbimesh arsimore, bibliotekë, librari, park, terrene sportive etj.





Shëndetësia



- ▶ **Spitali Rajonal Durrës**
 - Staf mjekësor 129
 - Infermierë 340
 - Shtretër 340
 - Qendra Shëndetësore cilat 4 QSH Turistike) 18 (nga të)

- ▶ **Spitali i Krujës**
 - Mjek specialist 26
 - Infermierë 76
 - Ambulanca 3 (2 në Krujë, 1 në QSH në Fushë Krujë)
 - Shtretër 124 (120 në pavione dhe 4 tek urgjenca)
 - Qendra Shëndetësore 6





Bizneset e Qarkut Durrës

▶ Qarku Durrës ka rreth **14 345 biznese**

- 2592 prodhues të të mirave,
 - 527 bujqësia, pyjet, peshkimi,
 - 1488 industria,
 - 577 ndërtimi,
 - 11753 prodhuesit e shërbimeve,
 - 5501 tregtia,
 - 805 transporti dhe magazinimi,
 - 2069 akomodimi dhe shërbimi ushqimor,
 - 172 informacioni dhe komunikacioni,
 - 3206 shërbime të tjera)
- ▶ 210 biznese të mëdha me mbi 50 punonjës.





Bujqësia

- ▶ Në bazë Qarku sipërfaqe toke bujqësore gjithsej është 76 442 ha nga të cilat tokë e punuar bujqësore është 29 912 ha, tokë e mbjellë frutikulturë 3805 ha.
- ▶ Drufrutore: pemtore 662 ha, ullinj 2350 ha, 29.43 ha, vreshta 765 ha.
- ▶ Janë mbjellë këto kultura bujqësore: drithëra 7236 ha, perime 2756, patate 517 ha, kultura industriale 134 ha, foragjere të njoma 18132 ha.
- ▶ Të dhëna për nr. e krerëve në Qark: gjedh 29 375, të leshta 39550, të dhirta 21869, derra 6420, njëthundrak 2085, shpendë 1702000 dhe bletë 11896 koshere.



JU FALEMINDERIT

